



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.104

2004

dhjetor

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9339
datë 21.12.2004

Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005..... 6921

LIGJ
Nr.9339, datë 21.12.2004

PËR BUXHETIN E SHTETIT TË VITIT 2005

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 158 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
BUXHETI I SHTETIT

Neni 1

Fondi i konsoliduar për vitin 2005 është:

Të ardhurat e Buxhetit të Shtetit	169 854 milionë lekë
Shpenzimet e Buxhetit të Shtetit	212 011 milionë lekë
Deficiti	42 157 milionë lekë

Fondi i konsoliduar përbëhet:

A. Buxheti Qendror:

Të ardhurat	159 499 milionë lekë
Shpenzimet	201 656 milionë lekë

B. Buxheti i pavarur i pushtetit vendor:

Të ardhurat	17 655 milionë lekë
Nga të cilat:	
Granti nga Buxheti Qendror	7 300 milionë lekë
Shpenzimet	17 655 milionë lekë

Neni 2

Buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2005 është:

A. Skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror

Të ardhurat, gjithsej	46 521 milionë lekë
- Nga kontributet	33 267 milionë lekë
- Transferimet nga Buxheti i Shtetit	13 254 milionë lekë
Shpenzimet	46 521 milionë lekë

Paga minimale, për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, deri në rritjen e pagave, është 11 376 lekë në muaj. Pas rritjes së pagave, Këshilli i Ministrave përcakton pagën e re.

B. Skema e sigurimit suplementar

Të ardhurat, gjithsej	2 758 milionë lekë
- Nga kontributet	55 milionë lekë
- Transferimet nga Buxheti i Shtetit	2 703 milionë lekë
Shpenzimet	2 758 milionë lekë

Neni 3

Buxheti i sigurimeve shëndetësore për vitin 2005 është:

Të ardhurat, gjithsej	5 893 milionë lekë
- Nga kontributet dhe të tjera	3 343 milionë lekë
- Transferimet nga Buxheti i Shtetit	2 550 milionë lekë
Shpenzimet	5 893 milionë lekë

KREU II

BURIMET PËR MBËSHTETJEN E SHPENZIMEVE BUXHETORE

Neni 4

Të ardhurat e Buxhetit të Shtetit sipas grupeve kryesore janë:

Grantet	6 920 milionë lekë
Të ardhurat tatimore	135 222 milionë lekë
Të ardhurat jotatimore	17 357 milionë lekë
Të ardhurat e buxhetit vendor	10 355 milionë lekë

Neni 5

Kufiri i financimit të deficitit të buxhetit të përgjithshëm nga burime të brendshme është 28 313 milionë lekë, nga i cili 4 951 milionë lekë financohen nga të ardhurat e privatizimit. Në rast mosrealizimi të të ardhurave të buxhetit dhe të ardhurave nga privatizimi, huamarrja për financimin e deficitit të brendshëm prej 23 362 milionë lekësh nuk ndryshon. Këshilli i Ministrave merr masa për kompensimin e diferencave nga burime suplementare ose nga shkurtimi i shpenzimeve.

Kufiri i financimit nga burimet e huaja është 13 844 milionë lekë, nga i cili mbështetja e drejtpërdrejtë për deficitin është 1 080 milionë lekë.

Neni 6

Disbalancimi i mundshëm gjatë vitit i buxhetit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore financohet nga fondi i garantimit të pensioneve të ISSH-së dhe fondi rezervë i ISKSH-së.

KREU III

SHPENZIMET E BUXHETIT TË SHTETIT

Neni 7

Shpenzimet sipas drejtimeve kryesore janë:

Shpenzimet korrente	156 396 milionë lekë
Shpenzimet kapitale	50 515 milionë lekë
Rezerva e Këshillit të Ministrave	1 000 milionë lekë
Kontingjenca	4 100 milionë lekë

Kufiri i shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion, i ndarë në fonde të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara, është sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij ligji. Për institucionet e pavaruara nga Këshilli i Ministrave kufiri i shpenzimeve, numri i punonjësve dhe fondi i pagave është sipas tabelës 1/1, që i bashkëlidhet këtij ligji. Këshilli i Ministrave vendos norma dhe standarde financiare për shpenzimet operative, të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjitha institucionet buxhetore, në varësi ose jo të Këshillit të Ministrave, si dhe për organet e pushtetit vendor.

Neni 8

Numri maksimal i punonjësve buxhetorë më 1 janar 2005, sipas të cilit është përgatitur Buxheti i Shtetit i vitit 2005, është 110 000 punonjës. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të përcaktojë numrin e punonjësve buxhetorë për çdo ministri dhe institucion qendror, me përjashtim të numrit të punonjësve të institucioneve të pavarura, që përcaktohen në tabelën 1/1, që i bashkëlidhet këtij ligji. Fondi i pagave i pashpërndarë përdoret për rritjen e diferencuar të pagave dhe mbështetjen e reformave në sistemin e pagave me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9

Shpenzimet kapitale nga burimet e brendshme janë 27 955 milionë lekë dhe nga burimet e huaja 22 560 milionë lekë. Investimet, sipas programeve, për çdo ministri dhe institucion qendror paraqiten në tabelën 2, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 10

Fondi i kontingjencës prej 4 100 milionë lekësh të përdoret:

- për ruajtjen e deficitit, me miratimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, 2 000 milionë lekë;
- për shlyerjen e detyrimeve të vjetra të ndërmarrjeve publike, me vendim të Këshillit të Ministrave, 1 500 milionë lekë;
- për zgjedhjet parlamentare, me vendim të Këshillit të Ministrave, 600 milionë lekë.

Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave përdoret për raste të paparashikuara dhe emergjente dhe jo për veprimarinë normale të institucioneve buxhetore.

Neni 11

Në fondet e kushtëzuara përfshihen shpenzimet për investime, me burim financimet e huaja, dhe shpenzimet nga të ardhurat, që, me ligj ose me akte të tjera nënligjore, u përkasin ministrive dhe institucioneve të tjera buxhetore. Fondet e kushtëzuara, me përjashtim të financimeve të huaja, përdoren brenda vitit buxhetor.

Neni 12

Fondet buxhetore për pushtetin gjyqësor paraqiten sipas tabelës 3, që i bashkëlidhet këtij ligji. Buxheti i pushtetit gjyqësor administrohet nga Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, në mbështetje të ligjit nr.8363, datë 1.7.1998. Bordi i kësaj Zyre mund të rishpërndajë deri në 10 për qind të totalit të fondeve për çdo nivel të pushtetit gjyqësor, si dhe të miratojë çdo transferim ndërmjet gjykatave të të njëjtit nivel, duke respektuar raportet ndërmjet shpenzimeve korrente dhe atyre kapitale, të paraqitura në tabelën 3, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 13

Transferrat e pakushtëzuara, që Buxheti Qendror ia transferon pushtetit vendor, përfshijnë fondet për përballimin e veprimtarive dhe të funksioneve, që përcaktohen në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Transferrat e pakushtëzuara shpërndahen ndërmjet organeve të pushtetit vendor, sipas formulës së paraqitur në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij ligji. Fondi rezervë, nga totali i transfertës së pakushtëzuar dhe granti ekualizues, përdoret nga Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe Ministria e Financave, në përputhje me kriteret e përcaktuara në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij ligji. Shuma e transfertës së pakushtëzuar për çdo organ të pushtetit vendor është paraqitur në tabelën 4, që i bashkëlidhet këtij ligji. Mënyra e financimit të funksioneve të

përbashkëta në sektorin e arsimit, të shëndetësisë, çështjeve sociale dhe shërbimeve publike jepet në aneksin 3 dhe fondet për investime në sektorët e arsimit dhe të shëndetësisë jepen në aneksin 3/1, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Fondet që, sipas këtij neni, u vihen në dispozicion organeve të pushtetit vendor, fondet e tjera që, me akte të tjera ligjore dhe nënligjore, u kalojnë organeve të pushtetit vendor dhe vendimet e këshillave të organeve të pushtetit vendor, që kanë lidhje me përdorimin e fondeve buxhetore, bëhen publike.

Neni 14

Kufiri i shpenzimeve, sipas pasqyrave 1, 1/1 dhe 2, që i bashkëlidhen këtij ligji, mund të rishpërndahet gjatë vitit ndërmjet ministrive/ programeve nga Këshilli i Ministrave deri në masën 5 për qind të çdo shume të paraqitur në këto tabela.

Neni 15

Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të borxhit të shtetit dhe atij të garantuar të shtetit, në dobi të palëve të treta përfituese, për vitin 2005 është 62 781 milionë lekë, i detajuar si më poshtë:

1. Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të borxhit të shtetit, si rezultat i zbatimit të buxhetit të vitit 2005, është 37 721 milionë lekë, nga i cili:

- për kreditë e jashtme, të drejtpërdrejta, të Këshillit të Ministrave është 14 358 milionë lekë;

- për financimin e brendshëm të deficitit buxhetor është 23 362 milionë lekë.

2. Kufiri për rritjen vjetore të garancive të shtetit në dobi të palëve të treta përfituese është 9 904 milionë lekë.

3. Kufiri për rritjen vjetore të stokut të borxhit, si rezultat i riskedulimit të borxheve të vjetra të jashtme të papaguara, është 3 656 milionë lekë.

4. Kufiri për rritjen vjetore të stokut të borxhit, si rezultat i mbulimit të diferencave nga rivlerësimi i valutave, është 11 500 milionë lekë, i cili emetohet në përputhje me shumat e rezultuara pas certifikimit të bilancit të Bankës së Shqipërisë.

Neni 16

Ngarkohet Ministria e Financave të nxjerrë udhëzime për zbatimin e këtij ligji.

Neni 17

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2005.

**Shpallur me dekretin nr.4442, datë 31.12.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

FORMULA E TRANSFERTËS SË PAKUSHTËZUAR - KRITERET DHE KOEFICIENTËT

Kriteri	Koeficient i	Vlera (në mijë lekë)	Arsyeja themelore
1. Alokimi i totalit të Transfertës së Pakushtëzuar (7.3miliard) [TP]			
Pjesa e Qarqeve [Q]	9%	657.000	Ky raport i alokon Qarqeve fonde të mjaftueshme për shpenzimet e tyre administrative , për mirëmbajtje dhe investime të rrugëve rurale, për shpenzime të tjera operative.
Pjesa për Bashkitë/Komunat [B/K]	91%	6.643.000	Për të siguruar financimin e funksioneve kryesore të ushtruara nga niveli i parë i QV. Pjesa e Transfertës së Pakushtëzuar për B/K është rritur në vitin 2005 , ndërsa fondi global i kompensimit për B/K/Q është eliminuar.
2. Shpërndarja e pjesës së Bashkisë/Komunës [B/K]			
Grant i përgjithshëm [GP] = [GP] * 1.00	100%	6.643.000	Pjesa e plotë për B/K alokohet në hapin e parë në grantin e përgjithshëm. Këto fonde mundësojnë mbulimin e nevojave për paga, kostot operative dhe disa investime lokale për funksionet e veta dhe kosto operative jopersoneli për funksionet e deleguara të përcaktuara në Aneksin 3 të ligjit të Buxhetit për vitin 2005. Nuk alokohen fonde të veçanta për kompensim; fondi i kompensimit krijohet nëpërmjet kompensimit të tranzicionit (shih me poshtë)
3. Shpërndarja e Grantit të Përgjithshëm për Bashkitë/Komunat			
Popullsia [P-B/K] = [GP-B/K] * 0.73	73.0%	4.849.390	Ky është kriteri dominant, pasi popullsia është një indikator i lidhur ngushtë me shpenzimet dhe nevojat për shërbime. Alokimi i [P-B/K/] ndahet proporcionalisht me popullsinë relative të çdo Bashkie/Komune kundrejt popullsisë totale. Ky koeficient është rritur me mbi 10 pikë (Shuma fikse është eliminuar si koeficient në vitin 2005).
Sipërfaqja e komunave [S-K] = [GP-B/K] * 0.12	12%	797.160	Ky element është i aplikueshëm vetëm për komunat. Komunë me sipërfaqe më të madhe nënkupton (për të gjithat kushtet e tjera të barabarta) se ka rrugë më të gjata dhe sfida të tjera infrastrukturore që kushtojnë. Sipërfaqja mesatare varion nga 22 deri 179 kilometër katror. Alokimi i [S-K] ndahet proporcionalisht me sipërfaqen relative të çdo komunë kundrejt

Kriteri	Koeficient i	Vlera (në mijë lekë)	Arsyeja themelore
			sipërfaqes totale. Për 174 komuna malore sipërfaqja është llogaritur si totali i sipërfaqes bazë shtuar me tetë herë.
Shërbimet Urbane [SU-B] $= [GP-B/K] * 0.15$	15%	996.450	Ky koeficient merr parasysh faktin që bashkitë sigurojnë një numër dhe gamë më të gjërë shërbimesh publike vendore se sa komunat Alokimi i [SU-B] ndahet proporcionalisht me popullsinë relative të çdo bashkie kundrejt popullsisë totale të bashkive. Për Bashkitë e vlerësuara si bashki në nevojë koeficienti i shërbimeve urbane është llogaritur duke shtuar me 2.5 herë numrin faktik të popullsisë. Për bashki malore, koeficienti i shërbimeve urbane është llogaritur duke shtuar me 2.5 herë numrin faktik të popullsisë. Për bashkitë malore e njëkohësisht në nevojë koeficienti i shërbimeve urbane është llogaritur duke shtuar 5 herë numrin faktik të popullsisë për këto bashki. Koeficienti i veçantë i shërbimeve urbane për Tiranën është eliminuar dhe bashkia është përfshirë në llogaritje me bashkitë e tjera.
4. Rregullimi i Ekualizimit Fiskal për Bashkitë dhe Komunat			
Ekualizimi Fiskal $(B/K_{PCR}-N_{PCR})*(+/- 35\%)*Popullsia$ $[PCR] -TAPF = Të$ ardhura për frymë $N = \text{nacionale}$	35%	648.819	Ekualizimi fiskal bazohet në të ardhurat faktike nga tatimi vendor mbi biznesin e vogël, tatimi i thjeshtëzuar mbi të fitimin (të ardhurat faktike të 6 mujorit të dytë të vitit 2003 + 6 mujorin e parë të vitit 2004), taksën e regjistrimit të automjeteve (faktike 2003). B/K që kanë të ardhura për frymë më të larta se sa të ardhurat nacionale për frymë kontribuojnë 35% të diferencës ndërmjet të dyjave shumëzuar me popullsinë e tyre. B/K që kanë të ardhura për frymë më të ulta se të ardhurat nacionale për frymë marrin 35% të së njëjtës diferencë të llogaritur në të njëjtën mënyrë.
Rregullimi tranzitor (rezultati negativ kundrejt vitit 2004) $(B/K_{R2004}-B/K_{R2003})*(0.100)$ $R = \text{të ardhura për një vit të dhënë}$	Kufiri 0.00% Koeficient i 100%	123.476	B/K të cilat, pas rezultateve të ekualizimit fiskal kanë një grant që është me i ulët se në vitin 2004 kompesohen për diferencën në masën 100 %

Kriteri	Koeficient i	Vlera (në mijë lekë)	Arsyeja themelore
Rregullimi tranzitor (rezultatet pozitive kundrejt vitit 2004)	Kufiri > 20 % Koeficient i 1.20 %	(803.496)	B/K të cilat, pas rezultateve të ekualizimit fiskal, përfitojnë një rritje të krahasuar me vitin 2004 mbi 20%, kufizohen në një rritje me 20% dhe për diferencën mbi 20 % kontribojnë për rritjen e garancisë minimale për frymë.
Kompensimi i garancisë minimale për frymë.	B – 3.500 minimumi për frymë K – 2.500 minimum për frymë	556.596	Për të siguruar një të ardhur të garantuar minimale për frymë, ky kompensim krahason të ardhurat përfundimtare për frymë (grantit të përshtatur për tranzicion, plus të ardhurat fiskale të listuara më përpara) me garancinë minimale prej (2500 lek/për frymë për komunitat, 3500 lek/për frymë për bashkitë). Bashkitë ose Komunitat marrin diferencën ndërmjet të dyjave, shumëzuar me popullsinë e tyre.
Fondi Neto i Kompensimit për bashkitë dhe komunitat [FNK-B/K]		123.424	Ky fond është produkt i elementeve të mëposhtëm: - Kompensimi tranzitor për rezultat negativ + Kompensimi tranzitor për rezultat pozitiv - Kompensimi I garancisë minimale për frymë Përdorimi i fondit kompensues për B/K bëhet sipas kriterëve të parashikuara, sic përshkruhet në Aneksin 3.
5. Shuma Finale e Grantit të Përgjithshëm për Bashkitë dhe Komunitat			
Shuma në total e shpërndarje se grantit për bashkitë dhe komunitat		6.519.576	
6. Shpërndarja e Pjesës së Grantit për Qarqet			
Granti i Përgjithshëm për Qarqet	98 %	643.860	Për financimin e funksioneve bazë të qarqeve.
Fondi i Kompensimit për Qarqet	2 %	13.140	Për financimin e rasteve të veçanta të shpenzimeve të qarqeve,
7. Shpërndarja e Grantit të Përgjithshëm për Qarqet			
Shuma fikse [SF-Q] = [Q] * 0.15	15 %	96.579	Shuma fikse alokon një shumë të barabartë për çdo qark . Shuma në total [SF-Q] ndahet barabar mes qarqeve (pjesëtohet me numrin e qarqeve 12)
Popullsia [P-Q] = [Q] * 0.25	25 %	160.965	Tipet e shërbimeve të siguruara nga qarku kanë një korrelacion negativ me popullsinë. Dhënia e një peshe më të madhe këtij kriteri do të penalizojë padrejtesisht më tepër qarqet më të varfëra dhe me më pak

Kriteri	Koeficient i	Vlera (në mijë lekë)	Arsyeja themelore
			banorë. Alokimi i [P-Q] bëhet proporcionalisht me popullsinë relative të cdo qarku kundrejt totalit të popullsisë.
Treguesi gjeografik [KG-Q] = [Q] * 0.30	30%	193.158	Ky është një tregues i rëndësishëm që merr parasysh avantazhet dhe disavantazhet natyrore të vendndodhjes së qarkut. Për të karakterizuar tre zonat tipike të vendit: fushore – kodrinore – malore u përdor një shkallë 1-3-5. (p.sh. Durrës = 1, Elbasan = 3, Kukës = 5). Sa më e lartë shkalla aq më të mëdha fondet që do të alokohen për këtë koeficient. Alokimi i [KG-Q] bëhet proporcionalisht me raportin e shkallës së qarkut kundrejt shumës së shkallëve për të gjithë qarqet (32). P.sh. Qarku Kukës merr 5/32 e shumës prej 193.158 mijeëlekë
Koeficienti i Rrugës [R-k] = [Q] * 0.30	30%	193.158	Alokimi [KR] ndahet proporcionalisht me gjatësinë relative të rrugëve për secilin qark, kundrejt gjatësisë totale.
8. Fonde të disponueshme për kompensim			
a. Kompensim për B/K b. Kompensimi për Q TOTALI		123.424 13.140 136.564	Përdorimi i këtyre fondeve të kompensimit do të bazohet në kriteret e caktuara paraprakisht dhe nga marrëveshja reciproke ndërmjet Ministrisë së Pushtetit vendor dhe Decentralizimit dhe Ministrisë së Financave.

ANEKS 2

Kriteret e Fondit të Kompensimit

Nivelet e Pushtetit Vendor	Kriteret
A. Fonde vetem për bashkitë dhe komunat	- kompensimi për ripshtatjen e kapacitetit fiskal, -kompensimi bazuar në kriterin e varferise (GPRS), -kompensimi për ndryshimin e numrit të popullsisë pas regjistrimit.
B. Fonde vetem për qarqet	-disa shpenzime operative që mund të nevojiten gjatë vitit.
C. Fonde për të gjitha qeverisjet vendore	-kriteret e sipërpërmendura për bashkitë, komunat dhe qarqet, -dhënie hua për tre mujorin e parë 2005 pa interes njesive të qeverisjes vendore që kanë mosperputhje midis nevojave për shpenzime dhe arketimit të taksave të tyre. Kthimi i huase do bëhet brenda datës 15 prill 2005.

Procedurat për alokimin e këtij fondi përcaktohen në udhëzimin e zbatimit të buxhetit të vitit 2005.

ANEKS 3

I. Funksione të përbashkëta në sektorin e arsimit dhe të shëndetësisë

1. SEKTORI I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR:

Pagesa e pagave të mësuesve: Bashkitë dhe komunat autorizohen të bëjnë pagesën e pagës së mësuesve të sistemit parauniversitar që punojnë në komunitetin e tyre sipas normave, mënyrës dhe afateve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës/drejtoritë arsimore. Bashkitë dhe komunat e përmbushin këtë funksion si një shërbim administrativ. Ministria e Arsimit dhe Shkencës jep të gjitha fondet e kërkuara për të paguar pagat e mësuesve, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Bashkitë dhe komunat nuk duhet të japin ndonjë fond nga buxheti i tyre për këtë qëllim. Shpenzimet për pagat e mësuesve nuk përbëjnë një shpenzim për bashkitë dhe komunat.

Funksionimi dhe mirëmbajtja e mjediseve të arsimit parauniversitar: Bashkitë dhe komunat kanë kompetencë të plotë për të siguruar mirëmbajtjen e të gjitha mjediseve të arsimit parauniversitar në komunitetin e tyre. Fondet për mirëmbajtjen e mjediseve të arsimit parauniversitar janë të përfshira në transfertën e pakushtëzuar që i jepet bashkive dhe komunave nga Buxheti i Shtetit. Çdo bashki dhe komunë vendos nivelin e financimit që ajo akordon për këtë funksion nga granti i pakushtëzuar, i dhënë nga Buxheti i Shtetit, si dhe nga burime të tjera të disponueshme në buxhetin e tyre. Ministria e Arsimit dhe Shkencës përgatit dhe nxjerr standarde minimale kombëtare të sigurisë dhe shëndetit të zbatueshme për mjediset e arsimit parauniversitar. Këto standarde nuk duhet të kufizojnë vendimmarrjen e bashkive dhe komunave në fushat me interes të qartë vendor. Shpenzimet e lidhura me funksionimin dhe mirëmbajtjen e mjediseve të arsimit parauniversitar miratohen si pjesë e buxhetit të çdo bashkie dhe komune.

Investimi

Në zbatim të VKM nr.632, datë 4.10.2004 “Për miratimin e dokumentit për politikën e decentralizimit në sektorin e arsimit parauniversitar”, në buxhetin e 12 bashkive qendër qarku dhe në 12 qarqet për njësitë e tjera të qeverisjes vendore për vitin buxhetor 2005 do të jetë një zë i veçantë i Buxhetit të Shtetit “Granti i kushtëzuar për ndërtim, rikonstruksion dhe pajisje të mjediseve të arsimit parauniversitar”, i cili paraqitet në një aneks të veçantë të ligjit. Bashkitë qendër qarku për investimet në territoret e tyre dhe këshillat e qarqeve për investimet në territoret e komunave dhe bashkive jo qendër qarku janë përgjegjëse për përdorimin e këtij buxheti.

Njësitë e qeverisjes vendore mund të financojnë nga të ardhurat e veta për ndërtim, rikonstruksion dhe pajisje të kopshteve dhe shkollave të arsimit parauniversitar. Bashkitë qendër qarku dhe këshillat e qarqeve përgjigjen për realizimin e investimeve të reja ndërtimore, riparimet kapitale dhe pajisjet e mjediseve të arsimit parauniversitar me fonde nga Buxheti i Shtetit, fondet e veta ose nga donatorët, mbi bazën e planit vjetor dhe duke respektuar standardet e vendosura nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës monitoron dhe kontrollon zbatimin e standardeve të vendosura nga ajo për rikonstruksion, ndërtim dhe pajisje të mjediseve të arsimit parauniversitar.

Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ministri i Financave dhe Ministri i Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, për procedurat e miratimit dhe zbatimit të buxhetit të investimeve për rikonstruksion, ndërtim dhe pajisje të mjediseve të arsimit parauniversitar, nxjerrin një udhëzim të veçantë.

2. SEKTORI I KUJDESIT PARËSOR SHËNDETËSOR:

Pagesa e pagave të personelit: Bashkitë dhe komunat autorizohen të bëjnë pagesën e pagave të punonjësve të personelit që punon në qendrat shëndetësore publike dhe poliklinikat në komunitetin e tyre sipas normave, mënyrës dhe afateve të përcaktuara. Bashkitë dhe komunat e përmbushin këtë funksion si një shërbim administrativ. Ministria e Shëndetësisë jep të gjitha fondet e kërkuara për të

paguar pagat e personelit. Bashkitë dhe komunat përdorin fondet e marra nga ky delegim vetëm për pagat e personelit sipas afateve të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë. Bashkitë dhe komunat nuk duhet të japin ndonjë fond nga buxheti i tyre për këtë qëllim. Shpenzimet për pagat e personelit, nuk përbëjnë një shpenzim për bashkitë dhe komunat.

Funksionimi dhe mirëmbajtja e mjediseve të shërbimit parësor shëndetësor

Fondet për mirëmbajtjen e mjediseve të shërbimit parësor shëndetësor dhe për shpenzimet e tjera operative shpërndahen nga Ministria e Shëndetësisë nëpërmjet institucioneve të saj si fonde të deleguara.

Investimi

Në zbatim të VKM nr.636, date 30.09.2004 “Për miratimin e dokumentit të politikave të decentralizimit në fushën e kujdesit shëndetësor parësor dhe mbrojtjen e shëndetit publik”, në buxhetin e 12 qarqeve për njësitë e qeverisjes vendore për vitin buxhetor 2005 do të jetë një zë i veçantë i Buxhetit të Shtetit “Granti i kushtëzuar për ndërtim dhe rikonstruksion të qendrave shëndetësore dhe ambulancave për shërbimin parësor shëndetësor”, i cili paraqitet në një aneks të veçantë të ligjit. Këshillat e qarqeve për investimet në territoret e komunave dhe bashkive janë përgjegjëse për përdorimin e këtij buxheti.

Njësitë e qeverisjes vendore mund të financojnë nga të ardhurat e veta për ndërtimin dhe rikonstruksionin e qendrave shëndetësore dhe ambulancave të shërbimit parësor shëndetësor. Këshillat e qarqeve përgjigjen për realizimin e investimeve të reja ndërtimore dhe riparimet kapitale me fonde nga Buxheti i Shtetit, fondet e veta ose nga donatorët, mbi bazën e planit vjetor dhe duke respektuar standardet e vendosura nga Ministria e Shëndetësisë.

Ministria e Shëndetësisë monitoron dhe kontrollon zbatimin e standarteve të vendosura nga ajo për rikonstruksion dhe ndërtim të qendrave shëndetësore dhe ambulancave për shërbimin parësor shëndetësor.

Ministri i Shëndetësisë, Ministri i Financave dhe Ministri i Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, për procedurat e miratimit dhe zbatimit të buxhetit të investimeve për rikonstruksion dhe ndërtim të qendrave shëndetësore dhe ambulancave të shërbimit parësor shëndetësor, nxjerrin një udhëzim të veçantë.

3. NDIHMA EKONOMIKE DHE SHËRBIMET E PËRKUJDESIT SHOQËROR:

Fondet për ndihmën ekonomike

Në zbatim të VKM nr.637, datë 30.09.2004 “Për miratimin e dokumentit të politikave të decentralizimit në fushën e ndihmës ekonomike dhe të shërbimeve të përkujdesit shoqëror”, fondet e ndihmës ekonomike në buxhetin e vitit 2005 janë fonde të kushtëzuara në kesh për familjet në nevojë, si dhe fonde të kushtëzuara për punë e shërbime në komunitet.

Në bazë të kërkesave të paraqitura nga njësitë e qeverisjes vendore për vitin 2005, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale programon në fillim të vitit fondet e ndihmës ekonomike (ndihmë në kesh për familjet në nevojë ose për punë dhe shërbime në komunitet) për çdo njësi të qeverisjes vendore.

Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale i delegon fondet e ndihmës ekonomike si grante të kushtëzuara për çdo njësi të qeverisjes vendore që në fillim të vitit.

- Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale çel në thesar, një herë në dy muaj, fondet që do t’u shpërndahen në kesh familjeve në nevojë nga bashkitë dhe komunat.

- Fondet e ndihmës ekonomike, të cilat destinohen në njësitë e qeverisjes vendore, që kushtëzojnë ndihmën ekonomike me punë e shërbime në komunitet, me kohë të plotë ose të pjesshme, çelen një herë në 4 muaj mbi bazën e vlerësimit të projekteve të paraqitura nga njësitë e qeverisjes vendore.

Të gjitha fondet e kursyera si rezultat i përdorimit me efektivitet të ndihmës ekonomike do të jenë kompetencë e përdorimit të njësisë së qeverisjes vendore.

Fondet e ndihmës ekonomike që shpërndahen në njësitë e qeverisjes vendore, bëhen të

njohura për të gjitha bashkitë dhe komunat. Kriteret e parimet e përdorura për shpërndarjen e këtyre fondeve bëhen publike për të gjitha njësitë e qeverisjes vendore.

Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministri i Financave dhe Ministri i Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit për këtë qëllim nxjerrin një udhëzim të veçantë.

Fondet për pagesën e personave me aftësi të kufizuar

Në bazë të vlerësimit të kërkesave (nga komisionet mjeko-ligjore) të paraqitura nga njësitë e qeverisjes vendore. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale programon që në fillim të vitit fondet për pagesën e personave me aftësi të kufizuar për çdo bashki dhe komunë në formën e grantit të kushtëzuar.

Çelja në thesar e fondeve për pagesën e personave me aftësi të kufizuar bëhet nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale çdo 2 muaj mbi bazën e vlerësimit të komisioneve mjekësore.

Fondet për pagesën e personave me aftësi të kufizuar që shpërndahen në njësitë e qeverisjes vendore bëhen të njohura për të gjitha bashkitë dhe komunat. Kriteret e parimet e përdorura për shpërndarjen e këtyre fondeve bëhen publike për të gjitha njësitë e qeverisjes vendore.

Fondet për përkujdesjen shoqërore

Financimi i shërbimeve të përkujdesit shoqëror, që realizohen nga bashkitë komunat dhe qarku, do të bëhet nga Buxheti i Shtetit, si dhe të ardhurat vendore. Fondet nga Buxheti i Shtetit jepen në formën e grantit të kushtëzuar nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale që në fillim të vitit, në përputhje me vlerësimin e nevojave në bazë të kërkesave dhe projekteve të paraqitura nga njësitë e qeverisjes vendore dhe fondeve në dispozicion.

Bashkitë dhe komunat administrojnë shërbimet e përkujdesit shoqëror për qendra të përkujdesit që u shërbejnë individëve, banorë të bashkisë ose komunës, si dhe shërbimet e përkujdesit për këta individë.

Qarqet administrojnë shërbimet e përkujdesit shoqëror për qendra të përkujdesit që u shërbejnë individëve të disa njësive të qeverisjes vendore në përbërje të qarkut.

Fondet për përkujdesin shoqëror që shpërndahen në njësitë e qeverisjes vendore bëhen të njohura për të gjitha bashkitë dhe komunat. Kriteret e parimet e përdorura për shpërndarjen e këtyre fondeve bëhen publike për të gjitha njësitë e qeverisjes vendore.

II. Fondet e shpërndara nga ministrinë e linjës

Sistemet e ujësjellësve të transferuar në pushtetin vendor dhe atyre në vazhdim që do të transferohen

Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit të bëjë shpërndarjen e subvencioneve për ndërmarrjet e transferuara gjatë vitit 2004 dhe ato që do të transferohen në vitin 2005 në njësitë e qeverisjes vendore, sipas të njëjtave kritere dhe parime që zbatohen për të gjitha ndërmarrjet e ujësjellësve.

Subvencionet për sistemet e transferuara të bëhen të njohura për të gjitha bashkitë dhe komunat.

Investimet për funksione të veta të pushtetit vendor

Fondet për investime për funksione të veta të qeverisjes vendore që shpërndahen nga ministrinë e linjës për pushtetin vendor të bëhen publike për të gjitha bashkitë dhe komunat.

Kriteret e parimet e përdorura për shpërndarjen e fondeve për investime të bëhen publike për të gjitha njësitë e qeverisjes vendore.

Aneksi 3/1

GRANT I KUSHTEZUAR PER NDERTIM RIKONSTRUKSION DHE TE ARSIMIT PARAUNIVERSITAR PER VITIN 2005, NE NIVEL BASHKIE QENDER QARKU

Nr	Emertimi i Bashkise	Kuota Totale per Bashkine, ne vitin 2005	Detyrime nga viti 2004 per Bashkine	Kuota per tu shperndare nga Bashkia per 2005		Kuota per tu shperndare nga Bashkia per 2005	
		Investime (Reab + Pajisje)	Ndertim + Rikonst.	Ndertim + Rikonst		Pajisje	
		ne mije leke	ne mije leke	ne mije leke	ne %	ne mije leke	ne %
1	Berat	27,932	13,770	10,724	3	3,439	3
2	Diber	20,696		15,671	5	5,025	5
3	Durres	78,952	60,000	14,351	4	4,602	4
4	Elbasan	74,012	49,150	18,825	6	6,036	6
5	Fier	41,885		31,715	10	10,170	10
6	Gjirokaster	16,911	1,700	11,518	4	3,693	4
7	Korce	39,158	12,920	19,868	6	6,371	6
8	Kukes	20,713		15,684	5	5,029	5
9	Lezhe	39,607	26,400	10,000	3	3,207	3
10	Shkoder	87,319	38,710	36,807	11	11,802	11
11	B. Tirane	382,421	242,740	105,766	33	33,915	33
12	Vlore	75,967	31,850	33,406	10	10,712	10
	Totali	905,573	477,240	324,335	100	104,001	100

Shenim:

Fondet e planifikuara per tu shperndare do te perdoren dhe per pajisje shkollore (tavolina, karrike etj.)

Aneksi 3/1

GRANT I KUSHTEZUAR PER NDERTIM RIKONSTRUKSION DHE TE ARSIMIT PARAUNIVERSITAR PER VITIN 2005, NE NIVEL QARKU (pa bashkine qender qarku)

Nr	Emertimi i Qarkut	Kuota Totale per Qarkun, ne vitin 2005	Detyrime nga viti 2004 per Qarkun	Kuota per tu shperndare nga Qarku per 2005		Kuota per tu shperndare nga Qarku per 2005	
		Investime (Reab + Pajisje)	Investime (Reab + Pajisje)	Investime (Reab + Pajisje)		Pajisje	
		ne mije leke	ne mije leke	ne mije leke	ne %	ne mije leke	ne %
1	Berat	62,236	7,865	40,943	9	13,428	9
2	Diber	37,330	3,340	25,596	5	8,394	5
3	Durres	56,098	18,230	28,516	6	9,352	6
4	Elbasan	140,163	80,615	44,841	9	14,706	9
5	Fier	96,516	54,086	31,951	7	10,479	7
6	Gjirokaster	33,984	6,165	20,948	4	6,870	4
7	Korce	102,506	57,090	34,200	7	11,216	7
8	Kukes	18,292	2,380	11,982	3	3,930	3
9	Lezhe	59,792	25,709	25,666	5	8,417	5
10	Shkoder	103,397	57,105	34,860	8	11,433	8
11	B. Tirane	376,776	175,590	151,500	32	49,686	32
12	Vlore	67,672	34,920	24,663	5	8,089	5
	Totali	1,154,762	523,095	475,666	100	156,000	100

Shenim:

Fondet e planifikuara per tu shperndare do te perdoren dhe per pajisje shkollore (tavolina, karrike etj.)

Aneksi 3/1

Granti i kushtëzuar për ndërtimin dhe rikonstruksionin e qendrave shëndetësore dhe të ambulancave në shërbimin parësor për vitin 2005

000/leke

Nr	Emertimi	Shuma		Nr	Emertimi	Shuma
I	Qarku Berat	30470		VII	Qarku Kukes	18130
1	Berat	14970		23	Kukes	5180
2	Skrapar	8280		24	Has	4650
3	Kucove	7220		25	Tropoje	8300
II	Qarku Diber	27720		VIII	Qarku Lezhe	28940
4	Diber	8180		26	Lezhe	7730
5	Bulqize	6750		27	Lac	5180
6	Mat	12790		28	Mirdite	16030
III	Qarku Durres	23710		IX	Qarku Tirane	42860
7	Durres	11350		32	Tirane	32950
8	Kruje	12360		33	Kavaje	9910
IV	Qarku Elbasan	33870		X	Qarku Korce	40640
9	Elbasan	11640		19	Korce	21700
10	Gramsh	3100		20	Devoll	7740
11	Librazhd	9320		21	Kolonje	5200
12	Peqin	9810		22	Pogradec	6000
V	Qarku Fier	28320		XI	Qarku Shkoder	25760
13	Fier	14920		29	Shkoder	4650
14	Lushnje	8220		30	M. Madhe	13890
	Rrethi					
15	Mallakaster	5180		31	Puke	7220
VI	Qarku Gjirokaster	23210	XII	Qarku Vlore	34180	
16	Gjirokaster	8030	34	Vlore	11910	
17	Permet	10000	35	Delvine	10850	
18	Tepelene	5180	36	Sarande	11420	
TOTALI						
QAROEVE					357810	

Tab.1

				ne 000/Leke
Kodmin	Buxheti i vitit 2005 sipas Ministrive dhe Institucioneve (ne mije Leke)	Fonde te pakushtezuara	Fonde te kushtezuara	Totali
1	Presidenca	203,000	1,000	204,000
2	Kuvendi	845,000	0	845,000
3	Keshilli Ministrave	657,000	438,996	1,095,996
4	Ministria Industrise dhe Energjitikes	994,900	4,025,218	5,020,118
5	Ministria Bujqesise dhe Ushqimit	3,652,000	2,898,150	6,550,150
6	Ministria e Rregullimit Territorit dhe Turizmit	5,918,550	5,037,450	10,956,000
7	Ministria e Ekonomise	497,000	235,000	732,000
8	Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit	9,418,525	5,147,740	14,566,265
9	Regjistrimi i Pasurive te Paluajtshme	96,000	225,000	321,000
10	Ministria e Financave	850,000	385,840	1,235,840
11	Ministria e Arsimit dhe Shkences	23,840,647	1,599,353	25,440,000
12	Ministria e Kultures, Rinise dhe Sporteve	1,401,100	354,900	1,756,000
13	Ministria e Shendetesise	16,954,500	1,519,228	18,473,728
14	Ministria e Drejtesise	2,691,381	965,724	3,657,105
15	Ministria e Puneve te Jashtme	1,607,000	10,000	1,617,000
16	Ministria e Rendit Publik	10,883,000	700,000	11,583,000
17	Ministria e Mbrojtjes	10,029,024	1,510,976	11,540,000
18	Sherbimi Informativ Shteteror	1,089,123	15,877	1,105,000
19	Drejtoria e Radio Televizionit	560,000	0	560,000
20	Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave	162,000	4,000	166,000
21	Drejtoria e Rezervave te Shtetit	110,000	75,000	185,000
22	Akademia e Shkences	523,000	44,200	567,200
24	Kontrolli Larte i Shtetit	226,000	0	226,000
25	Ministria e Punes dhe Ceshtjeve Sociale	27,502,000	436,000	27,938,000
26	Ministria e Mjedisit	186,000	114,500	300,500
27	Agjensia Kombetare e Privatizimit	35,000	58,000	93,000
28	Prokuroria e Pergjithshme	1,157,000	3,000	1,160,000
29	Zyra e Administrimit Buxhetit Gjygsor	1,339,395	605	1,340,000
30	Gjykata Kushtetuese	91,000	0	91,000
31	Agjensia Telegrafike Shqiptare	96,500	7,500	104,000
32	Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit	1,952,750	71,250	2,024,000
35	Drejtoria e Pergjithshme e Doganave	610,000	760,000	1,370,000
37	Drejtoria e Pergjithshme e Standartizimit	26,000	1,000	27,000
39	Drejtoria e Pergjith. e Pyjeve dhe Kullotave	670,000	200,000	870,000
40	Partite Politike	200,000	0	200,000

41	Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve	1,214,000	516,000	1,730,000
48	Drejtoria e Metrologjise dhe Kalibrimit	34,000	0	34,000
50	Instituti Statistikes	134,000	9,000	143,000
53	Komisioni i Letrave me Vlera	22,000	1,000	23,000
54	Enti Kombetar i Zonave te Lira	7,000	0	7,000
55	Shkolla e Magjistratures	66,550	450	67,000
56	Fondi i Zhvillimit Shqiptar	490,000	1,174,536	1,664,536
57	Qendra Kombetare e Kinematografise	94,600	400	95,000
59	Instituti I Integrimit te Perndjekurve Politik	31,000	0	31,000
63	Keshilli i Larte i Drejtesise	68,000	0	68,000
64	Keshilli Kombetar i RTV	5,000	0	5,000
66	Avokati i Popullit	85,000	0	85,000
67	Komisioni i Sherbimit Civil	56,000	0	56,000
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	146,000	0	146,000
75	Avokati i Shtetit	113,000	0	113,000
76	Inspektoriati i Larte Kontr. Deklarim Pasurise	132,000	0	132,000
77	Autoriteti I Konkurences	44,000	0	44,000
78	Ministria e Integrimit	180,000	10,000	190,000
79	Komiteti Shteteter i Kthimit dhe Kompensimit te Pronave	372,000	0	372,000
	Totali	130,368,545	28,556,893	158,925,438
	kontroll	130368545.195	28556892.861	158925438.056
		0	0	0

Tab.1.1

			ne 000 Lek	
		Nr.	Paga	Buxheti
Kodmin	Institucionet e Pavarura	Punonjesve	600 + 601	Total
1	Presidenca	66	64,000	204,000
2	Kuvendi	414	420,000	845,000
24	Kontrolli Larte i Shtetit	160	168,000	226,000
28	Prokuroria e Pergjithshme	800	65,000	1,160,000
29	Zyra e Administrimit Buxhetit Gjyqesor	1,230	880,000	1,340,000
30	Gjykata Kushtetuese	45	52,000	91,000
53	Komisioni i Letrave me Vlera	15	0	23,000
54	Enti Kombetar i Zonave te Lira	7	5,000	7,000
55	Shkolla e Magjistratures	22	21,000	67,000
63	Keshilli i Larte i Drejtesise	37	31,000	68,000
64	Keshilli Kombetar i RTV		0	5,000
66	Avokati i Popullit	45	50,000	85,000
67	Komisioni i Sherbimit Civil	28	31,000	56,000
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	60	98,000	146,000
75	Avokati i Shtetit	60	65,000	113,000
76	Inspekt. Larte Kontr. Deklarim Pasurise	30	47,000	132,000
77	Autoriteti I Konkurences	20	20,000	44,000

Tab.2

					ne 000 Lek		
Kodmin	Investimet e vitit 2005 sipas Ministrive dhe Institucioneve (ne mije Lek)	Nga Buxheti	Nga te Ardhurat	Financimi Huaj	Totali		
1	Presidenca	59,000	1,000	0	60,000	60000	0
011	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	59,000	1,000	0	60,000		
2	Kuvendi	85,000	0	0	85,000	85000	0
011	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	85,000	0	0	85,000		
3	Keshilli Ministrave	165,000	5,000	433,996	603,996	603996	0
011	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	103,800	5,000	0	108,800		
012	Administrata Publike	61,200	0	433,996	495,196		
4	Ministria Industrise dhe Energjitikes	579,000	10,000	3,991,118	4,580,118	4580118	0
011	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	28,000	1,000	0	29,000		
092	Mbeshtetje per Energjine	21,000	8,700	3,991,118	4,020,818		
113	Mbeshtetje per Gjeoshkencat e te tjera	440,000	300	0	440,300		
114	Mbeshtetje per Minierat dhe Nd/je Publike	90,000		0	90,000		
5	Ministria Bujqesise dhe Ushqimit	1,675,000	37,000	2,820,150	4,532,150	4532150	0
011	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	90,000	2,000	3,250	95,250		
102	Sherbimet e Insp. Bujq. Sig Ushq. e Mbr. Konsum.	43,500	34,800	125,000	203,300		
104	Infrastruktura e Ujitjes dhe Kullimit	936,000	0	1,502,700	2,438,700		
105	Mbesh.e prodh. Bujq, blek, agroind, dhe market.	333,500	200	858,100	1,191,800		
106	Kerkimi dhe Ekstensioni	50,000	0	0	50,000		
107	Menaxhimi i burimeve natyrore	201,000	0	273,800	474,800		
108	Zhvillimi i Integruar Rural	16,000	0	57,300	73,300		
109	Sherbimi Keshillimor	5,000	0	0	5,000		
6	Ministria e Rregullimit Territorit dhe Turizmit	4,496,000	9,000	4,986,000	9,491,000	9491000	0
011	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	64,000	9,000	0	73,000		
122	Infrastruktura Urbane	900,000	0	0	900,000		

073	Ujesjelles Kanalizime	2,464,000	0	4,369,561	6,833,561		
074	Strehimi dhe Urbanistika	618,000	0	616,439	1,234,439		
135	Programe te Turizmit	450,000	0	0	450,000		
076	Sherbimet Publike	0	0	0	0		
7	Ministria e Ekonomise	108,000	10,000	114,000	232,000	232000	0
011	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	108,000	10,000	114,000	232,000		
132	Mbeshtetje per Ndermarrjet ne Likuidim	0	0	0	0		
133	Mbeshtetje e Zhvillimit Ekonomik	0	0	0	0		
8	Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit	7,390,000	4,000	5,132,265	12,526,265	12526265	0
011	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	26,000	1,395	0	27,395		
122	Rrjeti i Rrugeve Nacionale	6,138,000	1,397	3,916,265	10,055,662		
123	Menaxhimi i Transportit Rrugor	26,000	600	0	26,600		
124	Portet	510,000	400	1,100,000	1,610,400		
125	Hekurudhat	400,000	0	0	400,000		
126	Transporti Publik	0	0	0	0		
127	Aviacioni Civil	290,000	208	116,000	406,208		
9	Regjistrimi i Pasurive te Paluajtshme	0	100,000	0	100,000	100000	0
011	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	0	100,000	0	100,000		
10	Ministria e Financave	122,000	1,000	373,840	496,840	496840	0
011	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	122,000	1,000	373,840	496,840		
012	Zbatimi i Vendimeve Gjyqesore	0	0	0	0		
013	Pagesa te menjehershme	0	0	0	0		
014	Mbeshtetje e Institucioneve Financiare	0	0	0	0		
11	Ministria e Arsimit dhe Shkences	3,328,000	414,000	598,000	4,340,000	4340000	0
011	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	38,000	10,000	0	48,000		
042	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	1,673,000	0	315,000	1,988,000		
043	Arsimi i Mesem (i pergjithshem)	684,600	0	133,000	817,600		
044	Arsimi i Mesem (profesional)	558,400	4,000	60,000	622,400		
045	Arsimi Universitar	274,000	400,000	90,000	764,000		
046	Programet Ars. dhe Trainimi i Mesuesve	0	0	0	0		
047	Fonde per Shkencen	100,000	0	0	100,000		
12	Ministria e Kultures, Rinise dhe Sporteve	431,000	8,000	302,000	741,000	741000	0

011	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	14,000	1,000	0	15,000		
082	Trashegimia Kulturore, Muzete, Bibliotekat	203,500	3,000	0	206,500		
083	Arti dhe Kultura	143,400	3,600	302,000	449,000		
084	Zhvillimi i Sportit	70,100	400	0	70,500		
085	Programe specifike kulturore	0	0	0	0		
13	Ministria e Shendetesise	2,140,000	65,000	1,118,728	3,323,728	3323728	0
011	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	37,000	9,000	0	46,000		
052	Sherbimet e Kujdesit Paresor	476,000	14,000	258,614	748,614		
053	Sherbimet e Kujdesit Dytesor	1,597,000	29,500	860,114	2,486,614		
055	Sherbimet e Shendetit Publik	30,000	12,500	0	42,500		
14	Ministria e Drejtesise	661,500	1,500	944,105	1,607,105	1607105	0
011	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	93,000	0	409,200	502,200		
012	Publikimet Zyrtare	2,000	0	0	2,000		
013	Mjekesia Ligjore	9,000	0	0	9,000		
034	Drejtoria e Pergjithshme e Burgjeve	549,000	0	534,905	1,083,905		
015	Sherbimi i Permbarimit Gjyqesor	8,500	0	0	8,500		
016	Sherbimet per çeshtjet e biresimeve	0	1,500	0	1,500		
15	Ministria e Puneve te Jashtme	115,000	0	0	115,000	115000	0
011	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	15,000	0	0	15,000		
012	Perfaqesite Diplomatike	100,000	0	0	100,000		
16	Ministria e Rendit Publik	290,000	233,000	0	523,000	523000	0
011	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	46,363	2,000	0	48,363		
042	Arsimi dhe Shkenca (Akademia)	0	0	0	0		
083	Kulture dhe Sport	0	0	0	0		
034	Policia e Shtetit	225,891	231,000	0	456,891		
035	Garda e Republikes	17,746	0	0	17,746		
17	Ministria e Mbrojtjes	1,190,000	1,000,000	0	2,190,000	2190000	0
011	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	24,584	0	0	24,584		
022	Sigurimi i Mbrojtjes	748,980	1,000,000	0	1,748,980		
043	Arsimi	260,100	0	0	260,100		
054	Shendetesia	129,690	0	0	129,690		
085	Kulture e Sport	7,926	0	0	7,926		
026	Mbesht.teknike e pune shkencore	18,720	0	0	18,720		
18	Sherbimi Informativ Shteteror	54,686	314	0	55,000	55000	0
011	Planifikimi, Menaxhimi dhe	52,286	70	0	52,356		

	Administrimi						
042	Arsimi	2,400	244	0	2,644		
19	Drejtoria e Radio Televizionit	100,000	0	0	100,000	100000	0
081	Sherbimet per shqiptaret jashte kufirit dhe sherbimi per te huajt ne gjuhe huaj + Sateliti	0	0	0	0		
082	Projekte teknike per futjen e teknologjive te reja	100,000	0	0	100,000		
083	Prodhime filmike ose veprimtari artistike mbarekombetare	0	0	0	0		
084	Orkestra Simfonike e RTSH dhe Kinematografise	0	0	0	0		
20	Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave	70,000	2,000	0	72,000	72000	0
011	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	70,000	2,000	0	72,000		
21	Drejtoria e Rezervave te Shtetit	0	5,000	0	5,000	5000	0
011	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	0	5,000	0	5,000		
22	Akademia e Shkences	58,000	8,000	4,200	70,200	70200	0
011	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	58,000	8,000	4,200	70,200		
24	Kontrolli Larte i Shtetit	18,000	0	0	18,000	18000	0
011	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	18,000	0	0	18,000		
25	Ministria e Punes dhe Ceshtjeve Sociale	265,000	9,000	397,000	671,000	671000	0
011	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	29,000	1,000	0	30,000		
062	Sigurimi Shoqeror	0	0	0	0		
063	Asistenca Sociale	0	0	0	0		
064	Sherbimet e Kujdesit Social	151,000	0	397,000	548,000		
065	Sherbimet e Punesimit	85,000	8,000	0	93,000		
26	Ministria e Mjedisit	59,800	1,200	112,500	173,500	173500	0
011	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	15,000	1,200	0	16,200		
072	Programe per mbrojtjen e Mjedisit	44,800	0	112,500	157,300		
27	Agjensia Kombetare e Privatizimit	0	5,000	0	5,000	5000	0
011	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	0	5,000	0	5,000		
28	Prokuroria e Pergjithshme	160,000	1,000	0	161,000	161000	0
011	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	160,000	1,000	0	161,000		

29	Zyra e Administrimit Buxhetit Gjygsor	207,880	120	0	208,000	208000	0
